

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, N.K. dhe L.T., që të dy nga fshati ..., Komuna e Klinës, për shkak të nga një vepre penale të kanosjes nga neni 185 pa 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit L.T., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, P.nr.201/2015, të datës 04.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 05.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e të akuzuarit L.T., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, P.nr.201/2015, të datës 04.04.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, P.nr.201/2015, të datës 04.04.2017, janë shpallur fajtor të akuzuarit N.K. dhe L.T., për shkak të nga një vepre penale të kanosjes nga neni 185 pa 1 të KPK, dhe secilit prej tyre i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej nga 600 (gjashtëqind) €, të cilin dënim janë obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 30 (tridhjetë) ditë, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

Janë obliguar të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sa do të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej nga 25 (njëzetë e pesë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesë pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari L.T., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose të njëjtit ti

shqiptohet dënimi më i butë, ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1022/2017, të datës 14.09.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit L.T., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e të akuzuarit L.T., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së të akuzuarit L.T., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e tij, ngase është e vështirë të kuptohet se L.T., a është palë e akuzuar apo është palë e dëmtuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale të kanosjes nga neni 185 pa 1 të KPK, si dhe gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në përpikëri dispozitat përkatëse ligjore përkitazi me ecurinë e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti është punuar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK, ngase përmban formën e kërkuar me shkrim, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale, duke i paraqitur në mënyrë të qarë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, ka vlerësuar saktësinë e të gjitha provave në këtë çështje penale dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme përkitazi me ekzistimin e veprës penale si dhe përgjegjësisë penale, për të vendosur çështjen juridike, dhe për të vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën nga neni 463 par 2 të KPPK, kur palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko - civil, andaj, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm dhe ka mbështetjen e duhur ligjore.

Për kundër asaj që i akuzuari L.T., aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk e ka ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal të parapara në kuptim të neni 385 të KPPK, se vepra penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit parashihet me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që i përjashtojnë të akuzuarit nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili është i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se

gjkata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së të akuzuarit L.T., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohehet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur kur të akuzuarin L.T., e ka shpallur fajtor, sepse i njëjti nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ngase në rastin konkret nuk ka patur kanosje, por vetëm kanë qenë fjalosje e momentit pa paramendim dhe aspak serioze.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, sikurse janë raporti fillestar i policisë në Klinë, deklarata e të akuzuarve dhe deklarata dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, të cilat prova gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku. Nga deklarata e të akuzuarve, N.K. dhe L.T., të dhëna në shqyrtim gjyqësor në mënyrë të qartë është vërtetuar se të akuzuarit seriozisht e kanë kanosur me njëri tjetrin me fjalë kërcënuese, ku i akuzuari Nikollë, i është drejtuar të akuzuarit Lorenc, me fjalët “nuk ke mi hangër 24 orë i gjallë”, ndërsa Lorenci të njëjtit i është drejtuar me fjalët “do t’iu rrotullojë së bashku me kioskë. Gjithashtu, nga deklarata e dëshmitarëve, Prek Gjokaj, Beni Lleshaj, Kristian Culaj dhe Pal Culaj, në mënyrë të qartë është vërtetuar se të akuzuarit ditën kritike seriozisht e kanë kanosur njëri tjetrin me fjalë e përshkuara si më lartë, andaj, kolegji i kësaj gjykate është i bindur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarit i ka shpallur fajtor dhe u ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Sipas ankesës së të akuzuarit L.T., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese sikurse janë, se i akuzuari ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike, se jeton në familje shumë anëtarësh, se të akuzuarit kanë arritur pajtimin në mes tyre, andaj, konsiderojë se dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, duke qenë e bindur se dënimi i shqiptuar është adekuat dhe në harmoni me peshën e veprave penale të kryera, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të tyre, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, andaj, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që

të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1005/2017 të datës 05.10.2017

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq